



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA E POLITIKAVE TË BUJQËSISË, PYJEVE, MJEDISIT,**  
**STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

**RAPORT PËRMBLEDHËS**

**Mbi monitorimin dhe publikimin e përqindjes së investimeve që adresojnë nevojat e grave, vajzave dhe grupeve të marginalizuara, periudha 2025**

**Bashkia Elbasan**

Ky raport hartohet në funksion të përmbushjes së masës së Planit të Integritetit:

**“Monitorim dhe publikim i përqindjes së investimeve që adresojnë nevoja të grave, vajzave dhe grupeve të marginalizuara”.**

**1. Qëllimi i raportit**

Raporti ka për qëllim:

- monitorimin e investimeve publike me ndikim social dhe gjinor;
- evidentimin e reflektimit të prioriteteve qytetare në planifikimin buxhetor;
- analizimin e investimeve që kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës së grave, vajzave dhe grupeve vulnerabël;
- publikimin e të dhënave dhe analizës në funksion të transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

**2. Metodologjia**

Analiza është realizuar mbi bazën e:

- procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje 2025–2026;
- konsultimeve publike në lagje dhe njësi administrative;
- pyetësorit publik online dhe fizik;
- analizës së planit të investimeve të Bashkisë Elbasan për vitin 2026;
- identifikimit të investimeve me ndikim social, komunitar dhe gjinor.

Procesi i konsultimit publik është zhvilluar në:

- 6 lagje urbane;
- 12 njësi administrative;
- platforma online dhe takime komunitare.

### 3. Analiza e pjesëmarrjes qytetare

<b>Treguesi</b>	<b>Vlera</b>
Pjesëmarrës gjithsej	2,020 qytetarë
Gra/Vajza	≈45%
Përfshirja e grave në pyetësonin online	≈65%
Pjesëmarrje mbi popullsinë totale	≈1.72%

Analiza evidencon një nivel të konsiderueshëm të pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse.

### 4. Prioritetet kryesore të evidentuara

Nga konsultimet publike janë identifikuar si prioritete kryesore:

- infrastruktura rrugore;
- ndriçimi publik dhe siguria;
- pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve;
- shërbimet sociale;
- aksesueshmëria;
- hapësirat komunitare dhe rinore;
- objektet arsimore dhe sportive.

Këto prioritete lidhen drejtpërdrejt me:

- sigurinë e grave dhe vajzave;
- aksesin në shërbime publike;
- përmirësimin e kushteve të jetesës;
- përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël.

### 5. Analiza e investimeve me ndikim social dhe gjinor

Nga analiza e investimeve të planifikuara në Buxhetin Vendor 2026 rezulton se një pjesë e konsiderueshme e investimeve adresojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi nevoja që lidhen me:

- gratë dhe vajzat;
- grupet vulnerabël;
- sigurinë publike;
- aksesueshmërinë;
- shërbimet sociale;
- arsimin dhe zhvillimin komunitar.

Investimet me ndikim social dhe gjinor përfshijnë:

- investime në ndriçim publik;
- sistemim dhe rehabilitim rrugësh;
- rikonstrukcion të objekteve arsimore;
- investime në qendra sociale dhe rinore;
- investime në hapësira komunitare;
- investime në menaxhimin e mbetjeve dhe mjedisin;
- investime në siguri rrugore dhe aksesueshmëri.

## 6. Përqindja e investimeve me ndikim social/gjinor

Treguesi	Vlera
Totali i investimeve të planifikuara 2026	611,142,817 lekë
Investime me ndikim social/gjinor	306,796,656 lekë
Përqindja ndaj totalit të investimeve	≈ 50.2 %

Analiza tregon se rreth gjysma e investimeve të planifikuara për vitin 2026 adresojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi nevoja sociale, komunitare dhe gjinore.

## 7. Gjetjet kryesore

- Procesi i konsultimit publik ka garantuar përfshirje të gjerë qytetare dhe territoriale.
- Vihet re rritje e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në konsultime.
- Prioritetet qytetare janë reflektuar në mënyrë të konsiderueshme në planifikimin e investimeve.
- Investimet me ndikim social dhe gjinor përbëjnë një pjesë të rëndësishme të planit të investimeve të Bashkisë Elbasan.
- Procesi ka kontribuar në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes me pjesëmarrje.

## 8. Përfundime

Bashkia Elbasan ka integruar dimensionin social dhe gjinor në procesin e planifikimit të investimeve publike përmes konsultimeve qytetare dhe mekanizmave të Buxhetimit me Pjesëmarrje.

Analiza eidenton se investimet prioritare të planifikuara për vitin 2026 kontribuojnë në:

- përmirësimin e sigurisë së grave dhe vajzave;
- rritjen e aksesit në shërbime publike;
- përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël;
- përmirësimin e kushteve të jetesës në komunitet;
- zhvillimin e qëndrueshëm vendor.

Ky raport publikohet në funksion të transparencës institucionale dhe monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Elbasan.